

EC

MA NDRYSHE

SHËNJESTRIMI I QËLLIMSHËM I ASETeve TË TRASHËGIMISË
KULTURORE NË KOSOVË 1998/99



DHJETOR 2024



SHËNJESTRIMI I QËLLIMSHËM I ASETeve
TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOSOVË
1998/99

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren,

Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, Prishtinë

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771 / 038 224 967

Hulumtimi " Shënjestrimi i qëllimshëm i aseteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë 1998/99" është realizuar në kuadër të projektit "Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni" që zbatohet nga EC Ma Ndryshe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	10
Konflikti, Trashëgimia dhe Ligji.....	12
Konventat Ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në konfliktet e armatosura.....	13
Konventa e Gjenevës (1949) dhe Protokollet Shtesë I dhe II (1977).....	13
Konventa e Hagës (1954).....	13
Konventa e UNESCO-s (1970).....	14
Konventa për Trashëgiminë Botërore (1972).....	16
Konventa për Objektet Kulturore të Vjedhura ose të Eksportuara në Mënyrë të Paligjshme (1995).....	17
E Drejta Penale Ndërkombëtare.....	17
E Drejta Ndërkombëtare e Njeriut.....	18
Lufta në Kosovë 1998-1999 dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore.....	19
Objektet fetare të shkatërruara gjatë luftës 1998/99.....	21
Shkatërrimi i ndërtesës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe arkivit të saj.....	34
Dëmtimi i kullave tradicionale dhe arkitekturës popullore.....	36
Libraritë e djegura gjatë luftës.....	50
Artefaktet e Kosovës të marra nga Serbia.....	51
Shkatërrimi i Çarshive të vjetra.....	53
Angazhimet e institucioneve të Kosovës për dokumentimin e krimeve të luftës drejtësi tranzicionale.....	55
Përbledhje dhe rekomandime.....	57
Bibliografia.....	58
Për EC-in:.....	59

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Suharekë, Xhamia e Bardhë pas shkatërrimit, fq. 14 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	22
Figura 2. Rahovec, (Marali), Xhamia e Maralisë pas granatimit, fq. 16 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	22
Figura 3. Prizren, (Lez), Mesxhidi I Lezit pas demolimit, fq.20 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	23
Figura 4. Podujevë, (Lluzhan), xhamia e Lluzhanit para shkatërrimit, fq. 22 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	23
Figura 5. Suharekë (Bllacë), Xhamia e Bllacës pas granatimit, fq.26 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	24
Figura 6. Podujevë, (Llapashticë e Epërme), Xhamia pas djegies dhe granatimit, fq.30 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	24
Figura 7. Rahovec, (Zatriq), Xhamia e Zatriqit pas djegies dhe granatimit, fq. 34 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	25
Figura 8. Gjilan, (Cërnica), Xhamia e Cërnicaës pas djegies, fq.38 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	25
Figura 9. Pejë, Xhamia e Pehlivani Mejdani pas demolimit dhe plaçkitjes, fq.52 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	26
Figura 10. Istog, Xhamia e Studenicës pas granatimit, Fq.58 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	26
Figura 11. Rahovec, Xhamia e Sokolit para dhe pas granatimit, fq.70 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	27
Figura 12. Junik, Xhamia e Junikut pas grantimit dhe demolimit, fq. 80 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	27
Figura 13. Istog, (Shushicë), Mesxhidi i Shushicës pas djegies, fq.86 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	28
Figura 14. Gjakovë, (Batushë), Mesxhidi I Batushës pas djegies dhe granatimit, fq. 94 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	28
Figura 15. Deçan, (Strellc), Xhamia e strellcit pas demolimit dhe granatimit, fq. 100 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	29
Figura 16. Podujevë ,(Bradash), Xhamia e Bradashit pas shkatërrimit, fq.98 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	29
Figura 17. Suharekë (Peçan), Xhamia e Peçanit para dhe pas grantimit, fq. 104 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	30
Figura 18. Mitrovicë, (Dedi), Mesxhidi i Dedisë pas djegies, fq. 106 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	30
Figura 19. Fushë Kosovë, (Harilaq), Xhamia e Harilaqit pas djegies, fq. 108 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	31
Figura 20. Gjakovë (Smolicë), Mesxhidi I Smolicës pas djegies, fq. 112 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	31
Figura 21. Rahovec, (Aztrozub), Xhamia e Astrozubit pas granatimit dhe djegies, fq. 114 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	32
Figura 22. Gjakovë, teqeja bektashiane pas djegies, fq. 46 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	32

Figura 23. Gjilan, teqeja e Sheh Tefikut pas djegies, fq.50 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	33
Figura 24. Djegia dhe shkatërrimi i LSHP.....	34
Figura 25. Djegia dhe shkatërrimi i LSHP.....	35
Figura 26. Junik, Kulla e Lush Uk Isufajt pas djegies, fq.144 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	36
Figura 27. Junik, Kompleks i Kullave në Junik pas djegies, Fq.142 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	37
Figura 28. Deçan, (Prejlep), Kulla e Ismet Hulajt pas djegies, fq. 156 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	37
Figura 29. Deçan, kompleksi i kullave pas djegies, fq.150 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	38
Figura 30. Nivokaz, Kompleksi i kullave në Nivokaz pas djegies, fq.148(Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	38
Figura 31. Deçan (Prejlep), Kompleksi i Kullave në Prejlep pas djegies dhe shkatërrimit, fq.154 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	39
Figura 32. Deçan,(Prejlep), Kulla e Shahni Qufajt pas djegies dhe shkatërrimit, fq. 158 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	39
Figura 33. Deçan (Prejlep), Kulla e Qëndrim Qufajt pas djegies, fq. 160 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	40
Figura 34. Deçan, (Prejlep), Kulla e Muhamet Shefjetit pas shkatërrimit, fq.162 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	40
Figura 35. Deçan, Kulla e Qaush Mushkolaj para dhe pas djegies, fq. 152 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	41
Figura 36. Deçan, (Prejlep), kulla e Januz Lokajt pas shkatërrimit, fq.166 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	41
Figura 37. Deçan, (Prejlep), kulla e Zymer Lokajt pas djegies, fq.164 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	42
Figura 38. Junik, Kulla e Nezir Pepshit pas djegies, fq. 146 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	42
Figura 39. Deçan (Drenoc), Kulla e Adem Berishës pas shkatërrimit, fq.172 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	43
Figura 40. Deçan (Drenoc), Kulla e Rifat Alajt pas shkatërrimi, fq.174 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	43
Figura 41. Deçan, (Srellc),Kompleksi i kullave pas djegies, fq.176 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	44
Figura 42. Kulla e Isuf Hylajt pas djegjes, fq.178 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	44
Figura 43. Deçan, (Strellc i ulët), Kulla e Musë Fetajt pas djegies, fq.180 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	45
Figura 44. Deçan, (Strellc i Epërm), Kulla me shtrirje horizontale pas djegies, fq.182 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	45
Figura 45. Istog, Kompleksi i Kullave të djegura, fq.184 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	46

Figura 46. Istog, Kulla e Qerim Alihajdarajt pas djegies, fq. 186 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	46
Figura 47. Istog, (Vrellë), Kulla e Dreshajve pas djegies, fq.188 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	47
Figura 48. Raushiq, (Pejë), Kulla e Kamber Aliajt pas djegies, fq. 190 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	47
Figura 49. Baran, (Pejë), Kulla e Rrustem Llukës pas shkatërrimit, fq. 192 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	48
Figura 50. Mitrovicë, Kulla e Sherif Gashit para djegies, fq.194 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	48
Figura 51. Kulla e Hysni Koshit pas djegies, fq.198 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	49
Figura 52. Arkivi Qendror Historik i Komunitetit Islam të Kosovës (KBI) në flakë, pasi u dogj nga policia serbe më 13 qershori 1999.....	50
Figura 53. Djegia e bibliotekës së Xhamisë së Hadum Sulejman Agës, nga trupat serbe në fund të marsit 1999. (Crimes of war, crimes of peace: Destruction of libraries during and after the Balkan wars of the 1990; Andras J. Riedlmayer).....	50
Figura 54. Riton, enë kulti (Neolit) - Reshtan, Suharekë (Arkeologo Blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka - Katalog).....	51
Figura 55. Tas dyvegjak (Periudha e Hekurit) - Romajë, Prizren (Arkeologo Blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka - Katallog).....	51
Figura 56. Enë sferike (Neolit) - Rudnik, Skenderaj (Arkeologo Blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka - Katalog).....	51
Figura 57. Figurinë antropomorfe, në altar me dekor të inçizuar (Neolit) - Fafos, Mitrovicë (Arkeologo Blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka - Katalog).....	51
Figura 58. Mahrama të ndryshme mëndafshi me motive florale (Arkeologo Blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka - Katallog).....	52
Figura 59. Veshje tradicionale gruaje, xhubletë punuar me fije ari (Arkeologo Blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka - Katalog).....	52
Figura 60. Çarshia e Vjetër, Pejë (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER).....	53
Figura 61. Çarshia e Vjetër Pejë - pas djegies dhe shkatërrimit (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER)....	53
Figura 62. Çarshia e Vjetër, Gjakovë (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER).....	53
Figura 63. Çarshia e Vjetër, Vushtrri (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER).....	54
Figura 64. Çarshia e Vjetër, Vushtrri - pas djegies (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER).....	54

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1. Asetet e shkatërruara gjatë luftës 1998-1999	20
Tabela 2. Xhamia e Bardhë, 1520 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	22
Tabela 3. Xhamia e Maralisë, 1529 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	22
Tabela 4. Mesxhidi i Lezit, 1650 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	23
Tabela 5. Xhamia e Lluzhanit, 1698 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	23
Tabela 6. Xhamia e Bllacës, 1711 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	24
Tabela 7. Xhamia e Llapashticës së Epërme, 1743 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	24
Tabela 8. Xhamia e Zatriqit, 1764 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	25
Tabela 9. Xhamia e Cernicës, 1775 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	25
Tabela 10. Xhamia e Pehlivani Mejdani, 1793 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	26
Tabela 11. Xhamia e Studenicës, 1803 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	26
Tabela 12. Xhamia e Sokolit, 1824 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	27
Tabela 13. Xhamia e Junikut, 1849 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	27
Tabela 14. Mesxhidi i shushicës, 1861 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	28
Tabela 15. Mesxhidi i Batushës, 1870 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	28
Tabela 16. Xhamia e Strellcit të Epërm, 1877 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	29
Tabela 17. Xhamia e Bradashit, 1877 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	29
Tabela 18. Xhamia e Peçanit, 1882 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	30
Tabela 19. Mesxhidi i Dedisë, 1884 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	30
Tabela 20. Xhamia e Harilaqit, 1890 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	31
Tabela 21. Mesxhidi i Smolicës, 1900 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	31
Tabela 22. Xhamia e Astrozubit, 1904 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	32

Tabela 23. Teqeja bektashiane,1790 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	32
Tabela 24. Teqeja Sheh Tefikut, shek.XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	33
Tabela 25. Kulla e Lush Uk Isufajt Shek. XVIII (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	36
Tabela 26. Kompleks i Kullave në Junik, shek. XVIII-XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	37
Tabela 27. Kulla e Ismet Hulajt, shek. XVIII (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	37
Tabela 28. Kompleksi i kullave në Deçan, shek. XVIII-XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	38
Tabela 29. Kompleksi i kullave në Nivokaz, Shek. XVIII-XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	38
Tabela 30. Kompleksi i Kullave në Prejlep, Shek. XVIII-XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	39
Tabela 31. Kulla e Shahni Qufajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	39
Tabela 32. Kulla e Qëndrim Qufajt, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	40
Tabela 33. Kulla e Muharrem Shefqetit, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	40
Tabela 34. Kulla e Mushkolajve, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	41
Tabela 35. Kulla e Januz Lokajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	41
Tabela 36. Kulla e Zymer Lokajt, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	42
Tabela 37. Kulla e Pepshëve, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	42
Tabela 38. Kulla e Adem Berishës, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	43
Tabela 39. Kulla e Rifat Alajt, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	43
Tabela 40. Kompleksi i kullave në Strellc, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	44
Tabela 41. Kulla e Isuf Hylajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	44
Tabela 42. Kulla e Musë Fetajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	45
Tabela 43. Kulla me shtrirje horizontale, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar n Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	45
Tabela 44. Kompleksi i Kullave në Istog, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	46

Tabela 45. Kulla e Qerim Alihajdarajt, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	46
Tabela 46. Kulla e Dreshajve, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	47
Tabela 47. Kulla e Kamber Aliajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	47
Tabela 48. Kulla e Rrustem Llukës, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	48
Tabela 49. Kulla e Sherif Gashit, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	48
Tabela 50. Kulla e Hysni Koshit, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.).....	49

HYRJE

Trashëgimia kulturore përfshin të gjitha asetet materiale dhe jo-materiale që janë të rëndësishme për identitetin dhe historinë e një komuniteti, populli ose kombi. Ajo përfshin elementë të ndryshëm që pasqyrojnë historinë, artin, zakonet, dhe traditat e një shoqërie.

Trashëgimia kulturore mund të ndahet në dy kategori kryesore:

Trashëgimia kulturore materiale: Ky është aspekti fizik i trashëgimisë dhe përfshin:

Monumentet historike: Ndërtesa dhe struktura me vlerë historike dhe arkitektonike, si kështjella, kisha, xhami, ndërtesa të tjera të rëndësishme.

Objektet e artit dhe shkrimet: Piktura, skulptura, artefakte arkeologjike, libra të vjetër, dorëshkrime dhe objekte që pasqyrojnë zhvillimin kulturor të një shoqërie.

Site arkeologjike: Vendbanime dhe zona që janë të rëndësishme për studimin e historisë dhe evoluimin e qytetërimeve.

Trashëgimia kulturore jo-materiale: Kjo përfshin praktikat, zakonet, traditat dhe shprehjet kulturore që janë të lidhura me një shoqëri, përfshirë:

Gjuha: Gjuhët dhe dialektet që janë përdorur dhe të cilat mbajnë vlera kulturore dhe historike për një popull.


Muzika, vallëzimi dhe teatri: Shprehje artistike që janë pjesë e traditave të një shoqërie.

Festat dhe ceremonitë: Tradita dhe praktika shoqërore që kanë kuptim të veçantë për një komunitet.

Trashëgimia kulturore është një aset shumë i çmuar për shoqëritë dhe kombet, pasi ajo mundëson lidhjen me të kaluarën, forcimin e identitetit kombëtar dhe kulturor, dhe ndihmon në mbajtjen e lidhjeve mes breznive të ndryshme. Për këtë arsy, ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore është një detyrim ndërkombëtar dhe kombëtar.

Megjithëkëtë, sulmet ndaj trashëgimisë kulturore gjatë konflikteve të armatosura ndodhin për disa arsy që lidhen me strategjitë dhe motivet e pjesëmarrësve në luftë. Disa nga arsyet kryesore përsë trashëgimia kulturore është e rrezikuar gjatë periudhave të luftës:

Shkatërrimi i identitetit kombëtar dhe kulturor: Pushtuesit ose grupet që përpilen të mbizotërojnë një territor mund të shkatërrojnë ose të dëmtojnë objektet kulturore si një mënyrë për të fshirë identitetin dhe historinë e popujve të pushtuar. Shkatërrimi i monumenteve, objekteve dhe siteve të rëndësishme kulturore mund të



të shërbejë si një metodë për të minimizuar lidhjet e popullatës me të kaluarën e saj dhe për të imponuar një kulturë të re.

Përfitimi ekonomik: Objektet kulturore shpesh janë të çmuara dhe mund të shiten ose trafikohen në tregjet ndërkombëtare të artit dhe antikiteteve. Gjatë konflikteve të armatosura, shumë pasuri kulturore mund të vjedhen dhe të shiten për të financuar operacione ushtarake, ose për të siguruar pasuri për individë ose grupe të caktuara.

Përdorimi i trashëgimisë kulturore si mjete strategjike: Ndodh që objektet dhe vendet e trashëgimisë kulturore të përdoren për qëllime ushtarake, si baza, mbrojtje, ose ndihmë në zhvillimin e strategjive luftarakë.

Kjo mund të bëhet për të përfituar nga pozita e këtyre vendeve ose për të fshehur veprimtarinë ushtarake pas monumenteve kulturore. Përdorimi i këtyre objekteve mund të çojë në rrezikimin e tyre, duke i bërë ato shënjestra për sulme të drejtpërdrejta.

Ndikimi i pasigurisë dhe konfuzionit: Gjatë luftës, mungesa e kontrollit dhe pasiguria e krijuar shpesh çon në shkatërrim të rastësishëm dhe dëmtim të trashëgimisë

kulturore. Kjo mund të ndodhë për shkak të bombardimeve, apo shpërbërjes së strukturave që kanë qenë të mbrojtura para luftës. Aktet e hakmarrjes dhe shkatërrimi simbolik: Sulmet ndaj trashëgimisë kulturore ndonjëherë janë motivuar nga dëshira për hakmarrje ose për të dërguar një mesazh simbolik kundër kundërshtarëve. Kjo mund të përfshijë shkatërrimin e objekteve që kanë vlerë të madhe për një grup tjeter etnik, fetar ose kulturor.

Strategjitë e terroristëve dhe dehumanizimi: Dëmtimi i trashëgimisë kulturore mund të përdoret si një mjet për të terrorizuar popullatën civile, duke e detyruar atë të humbë ndjenjën e sigurisë dhe përkatësisë. Shkatërrimi i objekteve që kanë vlera të forta kulturore dhe historike mund të sjellë pasoja të thella për moralin dhe identitetin e një kombi.

Kjo ka bërë që organizatat ndërkombëtare, të krijojnë instrumente të veçanta ligjore dhe mekanizma për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore gjatë konflikteve të armatosura, për të siguruar që ajo të ruhet dhe të mbrohet nga shkatërrimi.

KONFLIKTI, TRASHËGIMIA DHE LIGJI

Kultura, duke qenë në vijën e parë të konflikteve, shpesh bëhet viktimi e armiqësive. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore sipas UNESCO-s ushqen dhunën, urrejtjen dhe hakmarrjen midis njerëzve dhe dobëson vetë themellet e paqes, duke penguar pajtimin kur pluhuri i luftës bie.

Për këtë arsy, trashëgimia kulturore mbrohet në kohë konfliktesh nga një sërë konventash dhe ligjesh ndërkombëtare. Këto janë kryesisht instrumente ligjore të hartuara dhe miratuara nga shtetet. Edhe pse janë miratuar nga një numër i madh shtetesh, ato bëhen detyruese vetëm për ato shtete që vendosin t'i bashkohen, gjë që zakonisht bëhet përmes ratifikimit, aderimit, pranimit ose miratimit të Konventës nga shteti përkatës.

Sipas akademikëve, profesionistëve të trashëgimisë kulturore dhe hulumtuesve të pavarur ekzistojnë katër elemente thelbësore, të cilat janë detyruese për të gjitha shtetet gjatë konflikteve të armatosura, pavarësisht nëse ato e kanë pranuar kuadrin ligjor ose jo. Tre elementet e para janë të zbatueshme si në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe në ato jo-ndërkombëtare, ndërsa i katërti vetëm në konfliktet e armatosura ndërkombëtare:

Detyrimi i çdo pale në konflikt për të respektuar pasuritë kulturore.

Kujdes i veçantë duhet treguar gjatë operacioneve ushtarake për të shmangu

dëmtimin e ndërtesave të dedikuara fesë, artit, shkencës, arsimit ose qëllimeve bamirëse dhe monumenteve historike, përveç rasteve kur ato janë objektiva të domosdoshëm ushtarakë. Pasuritë e një rëndësie të madhe për trashëgiminë kulturore të çdo populli nuk duhet të bëhen objekt sulmi, përveç nëse kërkohet në mënyrë të domosdoshme nga nevoja ushtarake.

• Ndalesa për të përdorur pasuritë kulturore me rëndësi të madhe për qëllime që mund t'i ekspozojnë ato ndaj shkatërrimit ose dëmtimit, përveç rasteve kur kërkohet domosdoshmërisht nga nevoja ushtarake.

• Detyrimi i çdo pale në konflikt për të mbrojtur pasuritë kulturore.

Çdo konfiskim, shkatërrim ose dëmtim i qëllimshëm i bërë ndaj institucioneve të dedikuara fesë, bamirësise, arsimit, arteve dhe shkencave, monumenteve historike dhe veprave të artit e shkencës është i ndaluar. Çdo formë vjedhjeje, plaçkitjeje ose përvetësimi të paligjshëm, si dhe çdo akt vandalizmi ndaj pasurive me rëndësi të madhe për trashëgiminë kulturore të çdo populli, është i ndaluar.

• Detyrimi i fuqisë pushtuese për të parandaluar eksportimin e paligjshëm të pasurive kulturore nga territori i pushtuar dhe për të kthyer pasuritë e eksportuara në mënyrë të paligjshme autoriteteteve kompetente të territorit të pushtuar.

KONVENTAT NDËRKOMBËTARE QË LIDHEN ME MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KONFLIKTET E ARMATOSURA

Konventat më të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, sipas akademikëve, profesionistëve të trashëgimisë kulturore dhe hulumtuesve të pavarur janë:

1. KONVENTA E GJENEVËS (1949) DHE PROTOKOLLET SHTESË I DHE II (1977)

Të cilat ndalojnë plaçkitjen dhe shkatërrimin e pasurive kulturore nga forcat pushtuese. Konventa e Gjenevës (1949) përmban dispozita të caktuara që ndalojnë në mënyrë specifike dëmtimin e qëllimshëm ose të pajustifikuar të trashëgimisë kulturore të pambrojtur nga forcat pushtuese ose pushtuese. Ajo ndalon plaçkitjen: Shtetet Palë duhet të veprojnë për të parandaluar ose, nëse ka filluar, për të ndaluar plaçkitjen individuale dhe nuk mund të kryejnë ose autorizojnë plaçkitje të organizuar. Neni 53 ndalon qartësisht shkatërrimin e çdo pasurie (të paluajtshme ose të luajtshme), qofshin private, shtetërore, fetare ose të tjera.

Kjo konventë plotësohet nga dy Protokolle Shtesë (1977), të cilat përbajnjë dispozita të rëndësishme që lidhen specifisht me mbrojtjen e pasurive kulturore. Këto protokolle:

- ndalojnë sulmet kundër pasurive kulturore.
- ndalojnë përdorimin e pasurive kulturore për mbështetjen e përpjekjeve ushtarake.
- ndalojnë përdorimin e pasurive kulturore si objekt hakmarrjeje, pa përjashtim për nevoja ushtarake.

2. KONVENTA E HAGËS (1954)

Konventa e Hagës e vitit 1954 dhe Protokollet e saj të Parë dhe të Dytë (1954/1999) paraqet instrumentin ndërkombëtar që synon specifisht mbrojtjen e trashëgimisë kulturore gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimeve. Ajo përcakton rrethanat kur pasuritë kulturore mund të sulmohen dhe metodat për mbrojtjen e tyre.

Konventa kryesore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore është Konventa e vitit 1954 për Mbrotjen e Pasurive Kulturore në Rast të Konfliktit të Armatosur (Konventa e Hagës). Në përgjithësi, ajo trajton mbrojtjen e trashëgimisë kulturore gjatë konflikteve të armatosura dhe pushtimeve, nga dëmtimi, shkatërrimi dhe të gjitha format e përvetësimit të paligjshëm. Synimi i saj është që pasuritë kulturore, të luajtshme dhe të paluajtshme, të ruhen dhe respektohen.

Për më tepër, Protokolli Shtesë i konfirmon se pasuritë kulturore përfshihen në objektet civile, pasi nuk janë objektiva ushtarake. Ky protokoll gjithashtu:

- ndalon sulmet kundër popullsisë civile dhe objekteve civile (si pasuritë kulturore), duke kufizuar objektivat e ligjshme të sulmeve në objektiva ushtarake.
 - ngushton përkufizimin e një objekti ushtarak.
 - ndalon dëmet e tepruara dytësore ndaj popullsisë civile dhe objekteve civile.
- Këto rregulla mbështeten kryesisht nga sanksione penale. Protokolle të tjera shtesë të rëndësishme janë Protokolli i vitit 1980 mbi Ndalimet ose Kufizimet në Përdorimin e Minave, Kurthave dhe Pajisjeve të Tjera dhe ndryshimet e vitit 1996. Ky protokoll ndalon në çdo rr Ethanë përdorimin e kurthave dhe pajisjeve të tjera të ngjashme që në çfarëdo mënyre janë të lidhura me ose të vendosura pranë monumenteve historike, veprave të artit ose vendeve të adhurimit.

- Konventa plotësohet nga dy Protokolle:
- Protokolli i Parë, miratuar më 1954, dhe
 - Protokolli i Dytë, miratuar më 1999

Përcaktimi i pasurive kulturore sipas Konventës së Hagës:

- 01** Pasuri të luajtshme ose të paluajtshme me rëndësi të madhe për trashëgiminë kulturore të çdo populli, të tillë si:
- Monumente arkitekturore, artistike ose historike, qofshin fetare apo laike;
 - Site arkeologjike;
 - Grupe ndërtesash me interes historik ose artistik;
 - Vepra arti, dorëshkrime, libra dhe objekte të tjera me interes artistik, historik ose arkeologjik;
 - Koleksione shkencore, biblioteka dhe arkiva me rëndësi të madhe.

02 Ndërtesa të dedikuara për ruajtjen ose ekspozimin e pasurive kulturore të luajtshme, si muze, biblioteka të mëdha dhe depo arkivash.

03 Qendra që përmbajnë një sasi të madhe pasurish kulturore, të njoitura si "qendra që përmbajnë monumente".

Protokolli i Dytë (1999)

Ky protokoll forcon disa dispozita të Konventës dhe Protokollit të Parë lidhur me ruajtjen dhe respektimin e trashëgimisë kulturore. Ai prezanton një kategori të re, "mbrojtje e përforcuar", për pasuritë kulturore me rëndësi të jashtëzakonshme për njerëzimin, duke shtuar kategoritë ekzistuese të "mbrojtjes së përgjithshme" dhe "mbrojtjes së veçantë".

Protokolli i Dytë siguron:

- Njohjen dhe mbrojtjen më të lartë për pasuritë me vlera të jashtëzakonshme kulturore dhe historike.
- Ndalesën e përdorimit të pasurive kulturore për qëllime ushtarake ose për të mbrojtur objektiva ushtarake.
- Përcaktimin e sanksioneve penale për shkeljet e rënda kundër pasurive kulturore dhe kushtet për përgjegjësinë penale individuale.

Përgjegjësitë gjatë paqes

Shtetet Pale duhet:

- 01.Të përgatiten për mbrojtjen e pasurive kulturore në territorin e tyre, duke përfshire:
 - Hartimin e inventarëve;
 - Planifikimin e masave emergjente për mbrojtjen ndaj zjarrit ose shembjes strukturore;
 - Ruajtjen në vend ose zhvendosjen e pasurive kulturore të luajtshme.
- 02.Të shqyrtojnë përfshirjen e pasurive kulturore më të rëndësishme në Regjistrin Ndërkombëtar të Pasurive Kulturore nën Mbrojtje të Veçantë.
- 03.Të përdorin simbolin dallues "Mburoja Blu" për identifikimin e pasurive kulturore.

Përgjegjësitë gjatë konfliktit të armatosur
Shtetet Pale duhet:

- 01.Të respektojnë dhe mbrojnë pasuritë kulturore në territoret e tyre dhe ato të tjera, duke ndaluar çdo akt armiqësor ndaj tyre.
- 02.Të ndalojnë vjedhjen, plaçkitjen, eksportimin ose transferimin e paligjshëm të pasurive kulturore.
- 03. Të mos përdorin pasuritë kulturore për hakmarrje ose qëllime ushtarake.
- 04. Të ndjekin penalisht dhe të sanksionojnë ata që kryejnë shkelje të Konventës.

Pas konfliktit

Shtetet nënshkruese do:

- Kthejnë pasuritë kulturore të eksportuara në autoritetet kompetente të territorit të pushtuar.
- Ndalojnë mbajtjen e pasurive kulturore si reparacione lufte.
- Shkeljet serioze dhe përgjegjësia individuale
- Protokolli i Dytë përcakton pesë veprime që konsiderohen shkelje serioze, përfshire:
- Sulmet ndaj pasurive kulturore nën mbrojtje të përforcuar.
- Përdorimin e pasurive kulturore për qëllime ushtarake.
- Shkatërrimin masiv, vjedhjen ose vandalizmin ndaj pasurive kulturore.

Mburoja Blu

Konventa e Hagës prezanton emblemën dalluese "Mburoja Blu" për të identifikuar pasuritë kulturore. Ajo përdoret:

- Për të shënuar pasuritë kulturore nën mbrojtje të përgjithshme ose të veçantë.
- Për të identifikuar personelin që mbrojnë këto pasuri.

Simboli duhet të përdoret tri herë në formë trekëndore për vendet që kërkojnë mbrojtje të veçantë.

KONVENTA E UNESCO-S (1970)

Konventa e UNESCO-s e vitit 1970, e cila trajton ndalimin dhe parandalimin e importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë mbi pasuritë kulturore, është konventa ndërkontinentare më e gjere e ratifikuar në lidhje me trafikimin e paligjshëm të pasurive kulturore.

Trafiku ndërkontinentar i paligjshëm i objekteve artistike dhe kulturore është duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme. Vjedhjet, plaçkitjet, importi dhe eksporti i paligjshëm i

objekteve kulturore janë praktika të njohura, të cilat shpesh intensifikohen gjatë periudhave me siguri të ulët, si në kohë lufte. Kjo mund të jetë katastrofike për objektet arkeologjike, të cilat humbasin kontekstin ku janë gjetur, një element i domosdoshëm për interpretimin e tyre.

Për të luftuar më mirë këtë trafik, Konventa e UNESCO-s e vitit 1970 u hartua si një instrument pionier në këtë fushë. Konventa deklaron qartë se "eksporti dhe transferimi i pronësisë së pasurive kulturore si rezultat i detyrimit të kriuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga pushtimi i një vendi nga një fuqi e huaj do të konsiderohet i paligjshëm".

Masat parandaluese që shtetet pale duhet të ndërmarrin përfshijnë:

- Krijimi i inventarëve, certifikatave të eksportit, monitorimi i tregtisë, vendosja e sanksioneve penale ose administrative dhe organizimi i fushatave edukative.
- Zbatimi i masave, në përputhje me legjislacionin kombëtar, për të parandaluar që muzetë dhe institucionet e ngjashme në territorin e tyre të marrin pasuri kulturore me origjinë nga një Shtet Pale tjetër, të eksportuara në mënyrë të paligjshme.
- Ndalimi i importit të pasurive kulturore të vjedhura nga një Shtet Pale tjetër i kësaj Konverte.
- Rikuperimi dhe kthimi i pasurive kulturore të importuara në mënyrë të paligjshme, me kërkesë të Shtetit Pale të origjinës. Kjo dispozitë e rendësishme mbulon vetëm objektet e vjedhura të inventarizuara (objektet e nxjerra nga gjermimet e paligjshme ose të vjedhura nga banesa private përjashtohen).

Bashkëpunimi ndërkombeṭtar

Në rast se një objekt është identifikuar dhe gjendet jashtë vendit të tij të origjinës, bashkëpunimi ndërkombeṭtar bëhet i domosdoshëm. Ideja për të forcuar bashkëpunimin midis Shteteve Palë është thelbësore për Konventën. Në rast se trashëgimia kulturore është në rrezik nga plaçkitjet, Konventa ofron mundësinë për ndërmarrje specifike, si kontolle mbi importin dhe eksportin.

Data e Konventës - 1970 - konsiderohet zakonisht si data nga e cila këto dispozita duhet të zbatohen. Objektet e larguara në mënyrë të paligjshme para kësaj date nuk mbulohen nga Konventa.

KONVENTA PËR TRASHËGIMINË BOTËRORE (1972)

Konventa e vitit 1972 për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, e njojur si Konventa për Trashëgiminë Botërore, lidh në një dokument të vetëm konceptet e ruajtjes së natyrës dhe mbrojtjes së pasurive kulturore. Ajo përcakton detyrimet e Shteteve Palë për të identifikuar vendet potenciale me rëndësi të jashtëzakonshme për njerëzimin dhe rolin e tyre në mbrojtjen dhe ruajtjen e këtyre vendeve. Duke nënshkruar Konventën, çdo shtet angazhohet të ruajë jo vetëm vendet e Trashëgimisë Botërore në territorin e tij, por edhe të mbrojë trashëgiminë e tij kombëtare.

Listë e Trashëgimisë Botërore

Komiteti i Trashëgimisë Botërore vendoșe cilat vende do të përfshihen në Listën e Trashëgimisë Botërore. Deri në mars 2012, lista përbante 962 pasuri që Komiteti i konsideron me vlerë universale të jashtëzakonshme, si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të botës.

Listë Paraprake është një inventar i pasurive që çdo Shtet Palë synon t'i nominojë për Listën e Trashëgimisë Botërore në të ardhmen.

Listë e Trashëgimisë Botërore në Rrezik

Konventa gjithashtu parashikon një Listë të Trashëgimisë Botërore në Rrezik, që synon të informojë komunitetin ndërkombeṭtar për kushtet që kërcenojnë karakteristikat nën të cilat një pasuri është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore dhe të nxisë veprime korriguese. Konfliktet e armatosura dhe lufta konsiderohen rreziqe të mëdha për trashëgiminë botërore.

Nën këtë Konventë, Komiteti i Trashëgimisë Botërore mund të përfshijë në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik ato pasuri që kërkojnë operacione madhore për mbrojtjen dhe për të cilat është kërkuar ndihmë. Përfshirja e një vendi në këtë listë kërkon që Komiteti, në konsultim me Shtetin Palë përkates, të zhvillojë dhe miratojë një program për masa korriguese dhe më pas të monitorojë situatën e vendit. Të gjitha përpjekjet duhet të bëhen për të rivendosur vlerat e vendit dhe për ta hequr nga Lista e Trashëgimisë Botërore në Rrezik sa më shpejt të jetë e mundur.

Informimi dhe reagimi ndaj kërcenimeve

Shtetet Palë të Konventës duhet të informojnë Komitetin sa më shpejt të jetë e mundur për kërcenimet ndaj vendeve të tyre. Gjithashtu, individët privatë, organizatat joqeveritare ose grupe të tjera mund të térheqin vëmendjen e Komitetit ndaj kërcenimeve ekzistuese. Nëse paralajmërimi është i justifikuar dhe problemi është mjaftueshëm serioz, Komiteti mund të marrë në konsideratë përfshirjen e vendit në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik.

Ndihma emergjente dhe humbja e statusit

Përfshirja e një vendi në Listën e Trashëgimisë Botërore në Rrezik i mundëson Komitetit të Trashëgimisë Botërore të alokojë ndihmë të menjëhershme nga Fondi i Trashëgimisë Botërore për pasurinë në rrezik. Në raste ekstreme, si kur një vend i Trashëgimisë Botërore është i rrezikuar dhe nuk merren veprime të përshtatshme, një vend mund të hiqet nga lista dhe rrjedhimisht të humbasë statusin si vend i Trashëgimisë Botërore.

KONVENTA PËR OBJEKTET KULTURORE TË VJEDHURA OSE TË EKSPORTUARA NË MËNYRË TË PALIGJSHME (1995)

Emri i objektit -Kulla e Muharrem Shefqetit
Vendi - Prejlep
Komuna - Deçan
Koha e Ndërtimit - Shek. XIX
Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë
Gjendja para vitit 1998 - e mirë
Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999- u djeg dhe u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Kulla e Qëndrim Qufajt, Shek. XIX
Emri i objektit- Kulla e Qëndrim Qufajt
Vendi - Prejlep
Komuna - Deçan
Koha e Ndërtimit - XIX
Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë
Gjendja para vitit 1998 - e mirë
Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999- u djeg dhe u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Tabela 33. Kulla e Muharrem Shefqetit, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Figura 34. Deçan, (Prejlep), Kulla e Muharrem Shefqetit pas shkatërrimit, fq.162 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)





Figura 35. Deçan,
Kulla e Çauš
Mushkolaj para dhe
pas djegies, fq. 152
(Drançolli, Fejaz.
Trashëgimia e
shkatërruar në
Kosovë 1998-1999, Viti
2017.)

Tabela 34. Kulla e Mushkolajve, Shek. XIX (Drançolli,
Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999,
Viti 2017.)

Kulla e Januz Lokajt, shek. XIX

Emri i objektit -Kulla e Januz Lokajt

Vendi - Prejlep

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-

u djeg dhe u shkatërrua nga forcat
paramilitare, policia dhe ushtria serbe-
malaziase në pranverën e vitit 1999.

Kulla e Mushkolajve, Shek. XIX

Emri i objektit- Kulla e Çauš Mushkolajt

Vendi - Deçan

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u granata u djeg nga forcat
paramilitare, policia dhe ushtria serbe-
malaziase në qershori- shtatorë të vitit 1998.

Tabela 35. Kulla e Januz Lokajt, shek. XIX (Drançolli,
Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999,
Viti 2017.)

Figura 36. Deçan,
(Prejlep), kulla e
Januz Lokajt pas
shkatërrimit, fq.166
(Drançolli, Fejaz.
Trashëgimia e
shkatërruar në
Kosovë 1998-1999, Viti
2017.)





Figura 37. Deçan, (Prejlep), kulla e Zymer Lokajt pas djegies, fq.164 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Tabela 36. Kulla e Zymer Lokajt, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Kulla e Pepshëve, shek. XIX

Emri i objektit -Kulla e Pepshëve

Vendi - Junik

Komuna - Junik

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Kulla e Zymer Lokajt, Shek. XIX

Emri i objektit- Kulla e Zymer Lokajt

Vendi - Prejlep

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u rrënuar nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe- malaziase në pranverën e vitit 1999

Figura 38. Junik,
Kulla e Nezir Pepshit
pas djegies, fq. 146
(Drançolli, Fejaz.
Trashëgimia e
shkatërruar në
Kosovë 1998-1999, Viti
2017.)





Figura 39. Deçan (Drenoc), Kulla e Adem Berishës pas shkatërrimit, fq.172 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Tabela 38. Kulla e Adem Berishës, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Kulla e Adem Berishës, Shek. XIX

Emri i objektit- Kulla Adem Berishës

Vendi - Drenoc

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999

Kulla e Rifat Alajt, Shek. XIX

Emri i objektit -Kulla e Rifat Alajt

Vendi - Drenoc

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Tabela 39. Kulla e Rifat Alajt, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Figura 40. Deçan (Drenoc). Kulla e Rifat Alajt pas shkatërrimi, fq.174 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)





Figura 41. Deçan, (Strelc). Kompleksi i kullave pas djegies, fq.176 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Tabela 40. Kompleksi i kullave në Strelc, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999.

Tabela 40. Kompleksi i kullave në Strelc, Shek. XIX

Emri i objektit- Kompleksi i kullave

Vendi - Strelc

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u dogj dhe u rrënuar nga forcat paramilitare,
policia dhe ushtria serbe-malaziase në
pranverën e vitit 1999

Kulla e Isuf Hylajt, shek. XIX

Emri i objektit - Kulla e Pepshëve

Vendi - Strelcë i Ulët

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u rrënuar nga forcat paramilitare,
policia dhe ushtria serbe-malaziase në
pranverën e vitit 1999.

Tabela 41. Kulla e Isuf Hylajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)



Figura 42. Kulla e Isuf Hylajt pas djegjes, fq.178 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)



Figura 43. Deçan, (Strellc i ulët), Kulla e Musë Fetajt pas djegies, fq.180 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Tabela 42. Kulla e Musë Fetajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Kulla me shtrirje horizontale, Shek. XIX
Emri i objektit - Kulla me shtrirje horizontale
Vendi - Strellcë i epërm
Komuna - Deçan
Koha e Ndërtimit - Shek. XIX
Tipologjia - Shtëpi banimit i tipit kullë
Gjendja para vitit 1998 - e mirë
Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999 - e granatuar dhe e shkatërruar nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Kulla e Musë Fetajt, shek. XIX
Emri i objektit- Kulla Musë Fetajt
Vendi - Strellc
Komuna - Deçan
Koha e Ndërtimit - XIX
Tipologjia - Kullë
Gjendja para vitit 1998 - e mirë
Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999- u djeg nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Tabela 43. Kulla me shtrirje horizontale, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Figura 44. Deçan, (Strellc i Epërm), Kulla me shtrirje horizontale pas djegies, fq.182 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)





Figura 45. Istog,
Kompleksi i Kullave
të djugura, fq.184
(Drançolli, Fejaz.
Trashëgimia e
shkatërruar në
Kosovë 1998-1999, Viti
2017.)

Tabela 44. Kompleksi i Kullave në Istog, shek. XIX
(Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë
1998-1999, Viti 2017.)

Kompleksi i Kullave në Istog, shek. XIX
Emri i objektit- Kompleksi i kullave
Vendi - Istog
Komuna - Istog
Koha e Ndërtimit - shek. XIX
Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë
Gjendja para vitit 1998 - e mirë
Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999- u djeg nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Kulla e Qerim Alihajdarajt, Shek. XIX

Emri i objektit - Kulla Qerim Alihajdarajt

Vendi - Istog

Komuna - Istog

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Shtëpi banimit i tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

**Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u shkatërrua nga forcat
paramilitare, policia dhe ushtria serbe-
malaziase në pranverën e vitit 1999.**

Tabela 45. Kulla e Qerim Alihajdarajt, Shek. XIX
(Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë
1998-1999, Viti 2017.)

Figura 46. Istog,
Kulla e Qerim
Alihajdarajt pas
djęgies, fq. 186
(Drançolli, Fejaz.
Trashëgimia e
shkatërruar në
Kosovë 1998-1999, Viti
2017.)





Figura 47. Istog, (Vrellë), Kulla e Dreshajve pas djegies, fq.188 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Tabela 46. Kulla e Dreshajve, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Kulla e Dreshajve, Shek. XIX

Emri i objektit- Kulla e Dreshajve

Vendi - Vrellë

Komuna - Deçan

Koha e Ndërtimit - shek. XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Kulla e Kamber Aliajt, shek. XIX

Emri i objektit - Kulla e Kamber Aliajt

Vendi - Raushiq

Komuna - Pejë

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Shtëpi banimit i tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u dogj dhe u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia dhe ushtria serbe-malaziase në pranverën e vitit 1999.

Tabela 47. Kulla e Kamber Aliajt, shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Figura 48. Raushiq, (Pejë), Kulla e Kamber Aliajt pas djegies, fq. 190 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)





Figura 49. Baran, (Pejë), Kulla e Rrustem Llukës pas shkatërrimit, fq. 192 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Tabela 48. Kulla e Rrustem Llukës, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Kulla e Rrustem Llukës, Shek. XIX

Emri i objektit- Kulla Rrustem Llukës

Vendi - Baran

Komuna – Deçan

Koha e Ndërtimit - shek. XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u shkatërrua nga forcat paramilitare, policia
dhe ushtria serbe- malaziase në pranverën
e vitit 1999.

Kulla e Sherif Gashit, Shek. XIX

Emri i objektit - Kulla Halil Tolajt

Vendi - Mitrovicë

Komuna – Mitrovicë

Koha e Ndërtimit - Shek. XIX

Tipologjia - Shtëpi banimit i tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999-
u djeg dhe u shkatërrua nga forcat
paramilitare, policia dhe ushtria serbe-
malaziase në pranverën e vitit 1999.

Tabela 49. Kulla e Sherif Gashit, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatëruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Figura 50. Mitrovicë,
Kulla e Sherif Gashit
para djegies, fq.194
(Drançolli, Fejaz.
Trashëgimia e
shkatëruar në
Kosovë 1998-1999, Viti
2017.)





Tabela 50. Kulla e Hysni Kosit, Shek. XIX (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Figura 51. Kulla e Hysni Kosit pas djegies, fq.198 (Drançolli, Fejaz. Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998-1999, Viti 2017.)

Kulla e Hysni Kosit, Shek. XIX

Emri i objektit- Kulla e Hysni Kosit

Vendi - Gjakovë

Komuna – Gjakovë

Koha e Ndërtimit - shek. XIX

Tipologjia - Objekt i banimi të tipit kullë

Gjendja para vitit 1998 - e mirë

Gjendja gjatë vitit 1998 e deri me 6.12.1999- u tentua të digjej

LIBRARITË E DJEGURA GJATË LUFTËS

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës në Prishtinë i shpëtoi dëmeve të mëdha, bibliotekat publike në komuna të tjera të Kosovës, veçanërisht në zonat rurale, pësuan shkatërrime të tmerrshme. Deri në fund të luftës njëmbëdhjetë-javore, 65 nga 183 bibliotekat publike të Kosovës, një e treta e totalit, ishin shkatërruar plotësisht. Humbjet e kombinuara të rrjetit të bibliotekave publike të Kosovës u vlerësuan në 900,588 vëllime. Më shumë se një e treta e bibliotekave shkollore në Kosovë gjithashtu u shkatërruan gjatë luftës.

Një numër bibliotekash fetare dhe arkiva të komunitetit islam të Kosovës u dogjnë gjithashtu. Ndër to ishte biblioteka e vakëfit islam të Hadum Sulejman Agës në qytetin perëndimor të Kosovës, Gjakovë, e themeluar në vitin 1595 dhe e djegur nga trupat serbe në fund të marsit 1999, duke humbur plotësisht koleksionin e saj prej 200 dorëshkrimesh antiqe dhe 1,300 librash të shtypur të vjetër. Një tjetër humbje e pakthyeshme ishte ajo e arkivës qendrore historike të Komunitetit Islam të Kosovës, në Prishtinë, me dokumente të komunitetit që datonin më shumë se



Figura 53. Djegia e bibliotekës së Xhamisë së Hadum Sulejman Agës, nga trupat serbe në fund të marsit 1999. (Crimes of war, crimes of peace: Destruction of libraries during and after the Balkan wars of the 1990;

pesëqind vjet më parë, e cila u dogj nga policia serbe më 13 qershor 1999, pas armëpushimit dhe vetëm disa orë para mbërritjes së trupave të para paqeruajtëse të NATO-s në qytet.

Arkivi Qendror Historik i Komunitetit Islam të Kosovës (KBI) në flakë, pasi u dogj nga policia serbe më 13 qershor 1999, disa orë para mbërritjes së trupave të para paqeruajtëse të NATO-s. (Foto e mbrojtur nga të drejtat e autorit — Archive Photos/Reuters/Oleg Popov.)

Gjakovë (Kosovë). Biblioteka e Xhamisë së Hadum Sulejman Agës, e themeluar në vitin 1595. Biblioteka u dogj nga trupat serbe në fund të marsit 1999. Muri i saj i pasmë u shemb në maj të vitit 1999, kur maja e minares së xhamisë ngjitur u qëllua dhe ra mbi ndërtesën e bibliotekës. (Foto me mirësjellje të Prof. Sabri Bajgora, Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë.)



Figura 52. Arkivi Qendror Historik i Komunitetit Islam të Kosovës (KBI) në flakë, pasi u dogj nga policia serbe më 13 qershor 1999.

ARTEFAKTET E KOSOVËS TË MARRA NGA SERBIA

Kosova përballet ende me sfidën e rikthimit të trashëgimisë së saj kulturore të zhdukur ose të mbajtur padrejtësisht në vende të tjera, siç është Serbia. Një ndër çështjet më të rëndësishme dhe të ndjeshme është kthimi i 1,246 artefakteve të Kosovës, ndër të cilat 676 janë të karakterit arkeologjik dhe pjesa tjetër etnografike.

Këto artefakte, të cilat paraqesin vlera të jashtëzakonshme historike dhe kulturore, u morën fillimisht nga institucionet serbe nën pretekstin e një ekspozite të përkohshme. Megjithatë, pas përfundimit të qëllimit të deklaruar, artefaktet nuk u kthyen më në vendin e tyre të origjinës – Kosovë. Ky veprim përbën një shkelje të qartë të parimeve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe kthimin e trashëgimisë kulturore.

i Këto objekte, që datojnë nga periudha të ndryshme historike dhe që pasqyrojnë identitetin dhe historinë shumëdimensionale të Kosovës, përfshijnë vegla, stoli, artefakte të përdorimit të përditshëm, dhe objekte të lidhura me traditat dhe jetën etnografike. Humbja e këtyre thesareve nuk përfaqëson vetëm një humbje materiale, por edhe një goditje ndaj kujtesës kulturore dhe historike të Kosovës.

Institucionet e Kosovës kanë bërë vazhdimisht thirrje për kthimin e këtyre artefakteve, duke apeluar për respektimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të drejtës së popujve për t'u zotëruar trashëgiminë e tyre kulturore. Megjithatë, artefaktet ende mbahen padrejtësisht në Serbi, duke vazhduar kështu të pengojnë përpjekjet e Kosovës për të ruajtur dhe promovuar trashëgiminë e saj kulturore.

Fig.54. Riton, enë kulti (Neolit) - Reshtan, Suharekë (Arkeolosko blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka Katalog).



Fig.55. Tas dyvegjak (Periudha e Hekurit) - Romajë, Prizren (Arkeolosko blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka Katalog).



Fig.56. Enë sferike (Neolit) - Rudnik, Skenderaj (Arkeolosko blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka Katalog).



Fig.57. Figurinë antropomorfe, në altar me dekor të incizuar (Neolit) - Fafos, Mitrovicë (Arkeolosko blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka Katalog).



Kjo situatë kërkon vëmendjen dhe ndërhyrjen e organizatave ndërkombëtare të kulturës dhe trashëgimisë, si UNESCO, për të siguruar që këto artefakte të kthehen atje ku i përkasin – në vendin e tyre të originës, Kosovë. Kthimi i tyre nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një akt drejtësie dhe respekti ndaj historisë dhe identitetit të Kosovës.

Figura 58. Mahrama të ndryshme mëndafshi me motive florale (Arkeologo blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka Katalog)



Figura 59. Veshje tradicionale gruaje, xhubletë punuar me fije ari (Arkeologo blago - Kosovo i Metohija od neolita do ranog srednjek veka Katalog)



SHKATËRIMI I ÇARSHIVE TË VJETRA

Çarshitë e vjetra në Vushtrri, Gjakovë dhe Pejë përfaqësojnë pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore dhe ekonomike të Kosovës, duke qenë qendra të gjalla tregtare dhe simbole të historisë dhe jetës sociale të qyteteve përkatëse.

Gjatë konfliktit të viteve 1998–1999, këto hapësira historike u shkatërruan në mënyrë sistematike nga forcat serbe, duke shënjestruar jo vetëm strukturat fizike por edhe identitetin kulturor dhe historik që ato përfaqësonin.

Djegia, plaçkitja dhe rrafshimi i këtyre çarhive ilustron një përpjekje të qëllimshme për të zhdukur dëshmitë e kulturës dhe trashëgimisë shqiptare, duke lënë pasoja të thella jo vetëm në trashëgiminë arkitekturore, por edhe në jetën dhe kujtesën kolektive të komuniteteve lokale.

Tregimet e lidhura me këto tre çarshi shfaqin dëshmi të qarta të dhunës dhe qëllimit shkatërrimit të konfliktit, duke nxjerrë në pah rëndësinë e ruajtjes dhe dokumentimit të trashëgimisë kulturore si një akt rezistence dhe përkujtimi.

ÇARSHIA E VJETËR, PEJË

Kjo çarshi, e ndërtuar në shekujt XVIII dhe XIX, pësoi dëme të mëdha nga forcat serbe, të cilat plaçkitën dyqanet dhe i dogjën ato, duke përfshirë dyqanet e artizanëve shqiptarë dhe ato të filigranistëve katolikë. Dyqanet bamirëse të komunitetit islamik lokal gjithashtu u dogjën. Pas djegies, zona u rrafshua me buldozer.



Figura 60. Çarshia e Vjetër, Pejë (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER)



Figura 61. Çarshia e Vjetër Pejë - pas djegies dhe shkatërrimit (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER)



Figura 62. Çarshia e Vjetër, Gjakovë (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER)

ÇARSHIA E VJETËR, VUSHTRRI

Kjo çarshi, e ndërtuar në shekullin XV dhe e rikonstruktuar në shekullin XIX, u dogj nga paramilitarët serbë dy ditë pas fillimit të bombardimeve të NATO-s. Gjatë këtij sulmi, përveç djegies së xhamisë së tregut, u plakitën dhe dogjën 50 dyqane të çarshisë, dhe vendi u rrafshua me buldozer më 28 mars 1999. Ky sulm, sipas dëshmive, ishte i organizuar dhe i udhëhequr nga një politikan serb lokal.



Figura 63. Çarshia e Vjetër, Vushtrri (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER)



Figura 64. Çarshia e Vjetër, Vushtrri - pas djegies (Monument and Crime: The Destruction of Historic Architecture in Kosovo: ANDREW HERSCHER AND ANDRÁS RIEDLMAYER)

ANGAZHIMET E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS PËR DOKUMENTIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS DREJTËSI TRANZICIONALE

Për të dokumentuar krimet e luftës, përfshire krimet kundër trashëgimisë kulturore, në vitin 2011, institucionet e Republikës së Kosovës kanë themeluar Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës.

Ky Institut në vitin 2015 ka botuar monografinë "Monumentet e shkatërruara në Kosovë 1998/99" dhe në vitin 2017 ka botuar monografinë "Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99" me autor Fejaz Drançolli.

Në kapitullin e parë të monografisë "Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99" me autor Fejaz Drançolli pasqyrohen objektet fetare që janë shkatërruar gjatë luftës, ku figurojnë asete nga shekulli XVI e tutje, përfshire ato të prezantuar më sipër në këtë dokument.

Në kapitullin e dytë janë të përfshira objektet publike dhe selite e Bashkësisë Islame.

Njëkohësisht shpjegohet edhe marrja e arkivit të dokumenteve të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në qershor të vitit 1999 dhe bartja e tyre në ndërtesën e Muzeut të Krushevcit në Serbi.

Po ashtu përshkruhet se si në mars të vitit 1999 është demoluar dhe plaçkitur nga forcat serbe edhe Biblioteka e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kjo bibliotekë e karakterit të myllur dhe shfrytëzohej nga personeli i muzeut dhe kishte një fond të konsiderueshëm të librave dhe dokumenteve.

Ndërkaq në kapitullin e tretë zë shkatërrimi i trashëgimisë popullore përkatesisht objektet banesore.

Autori ka bërë të ditur se pos trashëgimisë kulturore të palëvizshme, në brendi të objekteve fetare e civile ka pasur edhe shumë artefakte, eksponate, dokumente arkivore, libra, veshje tradicionale, qilima, sixhade, armë e neë artizanale të punuara nga mjeshtrit shqiptarë. Po ashtu nga djegjet kanë

pësuar edhe dekorimet e punura në enterierët e objekteve të traditës të arkitekturës populllore të shekullit XVIII dhe XIX.

Mbi këtë bazë, nga autor Fejaz Drançolli janë realizuar edhe ekspozita të shkatërrimit të trashëgimisë shqiptare në Kosovë, ku veçohet "Shkatërrimi i Trashëgimisë Kulturore në Kosovë 1998-1999", e cila krasht Prishtinës e Gjakovës është hapur edhe në Tiranë, Ankara, Stamboll, Bursë e Vjenë.

Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës ndonëse me resurse të kufizuara është angazhuar në hulumtime, me c'rast edhe ka realizuar një numër botimesh për vrasjet e masakrat, por edhe për trashëgiminë kulturore, shkatërrimin e arkivave, etj.

Në vitin 2018 në kuadër të zbatimit të reformave në Ministrinë e Drejtësisë, ky institut është myllur, dhe në vend të tij është krijuar Departamenti për Drejtësinë Tranzionale.

Në vitin 2021 është themeluar Komisioni shtetëror për dokumentim të trashëgimisë kulturore të shkatërruar nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës së viteve 1998 - 1999. Sipas drejtuesve institucionalë ky dokumentim parashihej që ti hapte rrugë kërkesës së Kosovës për drejtësi dhe kompensim të dëmit të shkaktuar, që nuk është vetëm dëm material.

Në takimin e parë të këtij Komisioni, kryeministri Albin Kurti pati theksuar se gjatë luftës së viteve 1998-1999, krasht mijëra jetëve të humbura dhe dëmeve materiale, e shpirtërore, Kosova ka përjetuar humbje fatale të trashëgimisë së saj kulturore.

"Gjatë luftës, trashëgimia kulturore shqiptare është shënjestruar, plaçkitur dhe shkatërruar nga forcat e armatosura serbe. Shkatërrimi masiv, në zonat urbane e rurale, rezultoi me humbje dhe dëmtim serioz të ndërtesave tradicionale pjesë të trashëgimisë

kulturore, ku qindra xhami dhe objekte të besimit islam, qendra historike, kulla, ndërtesa tradicionale, biblioteka, arkiva, muze janë shkatërruar. Trashëgimia ndërtimore nuk ishte kategoria e vetme e shkatërruar, por gjatë periudhës 1998-1999 me mijëra objekte nga koleksioni muzeor i Muzeut Kombëtar të Kosovës, dhe dokumente origjinale arkivore janë marrë dhe vazhdojnë të mbahen padrejtësisht në Serbi. Në gjykimet e Tribunalit të Hagës, shkatërrimi i qindra monumenteve të Kosovës gjatë luftës është cilësuar si krim kundër njerezimit. Tribunali ka dënuar gjashtë zyrtarë të Ushtrisë Serbe, policisë dhe zyrtarë shtetërore si përgjegjës për një fushatë dhune masive, përfshire shkatërrimin e xhamive dhe objekteve tjera fetare, gjatë luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë. Megjithatë shumë pak e kanë thënë që shkatërrimet në fjalë janë një komponent kyç i krimave të kryera gjatë luftës. E kjo është edhe një prej arsyeve pse na duhet të nisim këtë diskutim e të bëjmë shumë punë mbi adresimin e shkatërrimeve të kryera".

Ai pat shprehur kënaqësinë që ftesës për të kontribuar i janë përgjigjur ekspertë shumë të nderuar vendorë e ndërkombëtarë, përfshire dy ekspertët, të cilët kanë mbrojtur trashëgiminë kulturore të shkatërruar në Tribunalin Ndërkombëtar të Hagës, z. Riedlmayer dhe z. Herscher.

Gjetjet nga Komisioni shtetëror për hulumtimin dhe dokumentimin e trashëgimisë kulturore të shkatërruar gjatë luftës së vitit 1998-1999, në mënyrë telegrafike janë publikuar në maj të vitit 2023 nga ministri i MKRS-së, Hadrulla Çeku.

"Një përbledhje e shkatërrimit të qëllimshëm të trashëgimisë kulturore të Kosovës nga agresioni serb gjatë luftës së viteve 1998/99:

- 1788 objekte të trashëgimisë kulturore të dëmtuara/shkatërruara,
- mbi 3000 artefakte muzeale të vjedhura,
- 1.7 milionë libra shqip dhe 175 biblioteka publike të djegura/shkatërruara,
- mbi 25 mijë dokumente të trashëgimisë të marra,
- qindra vepra arti të vjedhura, të djegura ose të dëmtuara.

Deri më sot, asnjë kërkim falje, asnjë përgjegjësi nuk është marrë, asnjë kompensim nuk është dhënë, dhe as drejtësi nuk është siguruar", ka shkruar ai në platformën X

(<https://x.com/HCeku/status/1659895580510879744>).

Ndërkaq deputetët e Kuvendit të Kosovës, më 13 korrik 2023, miratuan Ligjin për Institutin e Krimave të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, duke i hapur kështu rrugë themelimit të këtij instituti.

Më 17 shkurt 2024, në Institutin për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), u bë pranimi i dokumenteve të para për krim luftë.

Ndërkaq në shtator të vitit 2024, ministri i MKRS-së, Hadrulla Çeku ka ndarë punën e bërë nga MKRS për dokumentimin e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore gjatë luftës. Sipas njoftimit të IKKL, MKRS-ja ka dorëzuar dokumentacion të vlefshëm me të dhëna të rëndësishme për dëmet ndaj trashëgimisë kulturore gjatë luftës në Kosovë.

Atdhe Hetemi, drejtor i Institutit për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, në një paraqitje mediale në nëntor të vitit 2024 ka thënë se IKKL ka karakter dokumentues dhe se synon të prodrojë materiale kredibile që do të përdoren si referencë në punimet shkencore akademike dhe raporte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME:

Dokumentimi i shkatërrimit të trashëgimisë kulturore ndihmon në sigurimin e një pasqyre të saktë historike dhe për të mos lejuar që këto kime të harrohen ose të mohohen.

Mbledhja e provave është thelbësore për të ndjekur penalisht ata që kryen këto akte dhe për të kërkuar drejtësi për popullin e Kosovës. Këto kime janë shkelje e të drejtës ndërkombëtare dhe përbëjnë një kërcënëm për trashëgiminë globale.

Dokumentimi ndihmon në procesin e shërimit dhe pajtimit duke e bërë të qartë se këto akte janë të dënueshme dhe se shkatërrimi i trashëgimisë kulturore është një krim kundër identitetit të një populli.

Identifikimi dhe dokumentimi i dëmeve ndihmon në mbrojtjen dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë në të ardhmen, duke krijuar masa parandaluese për konflikte të tjera.

Në të njëjtën kohë duhet prezantuar ato te opinioni ndërkombëtar, përmes përcjelljes së fakteve në organizata si UNESCO, Gjykata

ndërkombëtare Penale dhe organizata të tjera që merren me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të drejtave të njeriut.

Hartimi i raporteve të detajuara mbi krimet dhe dëmet e shkaktuara, të cilat mund të shpërndahen përmes mediave ndërkombëtare, konferencave dhe organizatave akademike.

Përdorimi i dokumentarëve, ekspozitave dixhitale, dhe projekteve multimedia për të treguar historinë dhe për të ndërgjegjësuar opinionin global mbi krimet e kryera.

Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe ekspozitave ndërkombëtare që nxjerrin në pah dëmet ndaj dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Ndërtimi i partneriteteve me shtete dhe organizata ndërkombëtare për të garantuar mbështetje për dokumentimin dhe ruajtjen e trashëgimisë.

Prezantimi i historive të njerëzve të prekura nga shkatërrimi i trashëgimisë për të krijuar një lidhje emocionale dhe për të rritur ndërgjegjësimin për pasojat humanitare.



BIBLIOGRAFIA:

- TRASHËGIMIA E SHKATËRRUAR NË KOSOVË 1998/99 / DESTROYED HERITAGE IN KOSOVA 1998/99 nga Fejaz Drançolli (Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës)
- "BARBARIA SERBE NDAJ MONUMENTEVE ISLAME NË KOSOVË", Bashkësia Islame e Kosovës, kryeredaktor Sabri Bajgora (Shtëpia Botuese "Dituria Islame", 2000)
- MONUMENT AND CRIME: THE DESTRUCTION OF HISTORIC ARCHITECTURE IN KOSOVO Author(s): Andrew Herscher and András Riedlmayer
- MUSEUMS IN KOSOVO: A FIRST POST-WAR ASSESSMENT Andras J. Riedlmayer (Harvard University)
- SOFIA SEMINAR REPORT ON LEGISLATIVE REFORM IN THE FIELD OF CULTURAL HERITAGE KOSOVO (UNMIK) Presentation by: Gjejlane Hoxha, Ministry of Culture, Youth and Sports, Provisional Institutions of Self-Government of Kosovo - Kosovo (UNMIK)
- CULTURAL HERITAGE IN SOUTH-EAST EUROPE: KOSOVO UNITED NATIONS EDUCATIONAL, SCIENTIFIC AND CULTURAL ORGANIZATION (UNESCO)
- KOSOVO'S CULTURAL HERITAGE TREASURY AS A WAR HOSTAGE IN BELGRADE AND UNESCO Academy of Albanological Studies. Tirana. Albania. Alfred Peza
- RAPORTI PËR PROJEKTET E INVESTUARA NË TRASHËGIMI KULTURORE NGA MKRS 2008-2018 (Analizë e gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore)
- KOSOVO: CULTURAL HERITAGE IN CONFLICT MICHELLE DEFREESE
- TRADITIONAL HOUSES IN WESTERN KOSOVO: A DESCRIPTIVE SURVEY OF KULLAS IN THE MUNICIPALITIES OF ISTOG AND KLINE. Sahar Rassam, Architect Former Housing Coordinator and Municipal Housing Committee Chair, United NationsMission In Kosovo (UNMIK).
- "THE RESTORATION OF THE HADUM MOSQUE COMPLEX IN GJAKOVA: A CAUTIONARY TALE", UNMIK's Department of Culture.
- IDENTITY AND CONFLICT: CULTURAL HERITAGE, RECONSTRUCTION AND NATIONAL IDENTITY IN KOSOVO AUTHOR: Anne-Françoise Morel
- MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOSOVË (OSCE)
- TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS (KONCEPTET DHE KONTEKSTET E MBROJTJES)
Florina Jerliu
- PRIZRENI I LASHTË - Muhamed Shukriu
- VIOLENCE TAKING PLACE: THE ARCHITECTURE OF THE KOSOVO CONFLICT by Andrew Herscher Stanford, California: Stanford University Press, 2010
- STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE 2017-2027 (MKRS)
- ARKEOLOSKO BLAGO - KOSOVO I METOHIIA OD NEOLITA DO RANOG SREDNJEK VEKA - KATALOG
- <https://www.heritageforpeace.org/heritage-for-peace/legal-framework/>
- <https://www.unesco.org/en/heritage-armed-conflicts>
- <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2584>
- <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/kryeministri-kurti-mori-pjese-ne-takimin-e-pare-te-komisionit-shteteror-per-hulumtimin-dhe-dokumentimin-e-trashegimise-kulturore-te-shkaterruar-gjate-lufte-s-e-vitit-1998-1999/>

PËR EC-IN:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarres publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore. Për përbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: 1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, 2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe 3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve përpale të treta. Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

01 Gjithëpërfshirjen,

02 Qëndrueshmërinë, dhe

03 Dijken.

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që

duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

01. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukëta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të janë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsjon;

02. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të janë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkë veprimin qytetar për të përbushur misionin e organizatës;

03. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;

04. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.

www.ecmandryshe.org

